

Shahin Toçi

*Ku del shqipja e flet me gurin
qoftë mallkue kush ndërron flamurin*





(1914 – 1939)

Vendlindja

*Mati,
kjo kështjellë madhështore
e sajuar bujarisht nga natyra,
zë një vend të rëndësishëm në historinë
mijëravjeçare të Shqipërisë*

Mati, kjo kështjellë madhështore e sajuar bujarisht nga natyra, zë një vend të rëndësishëm në historinë mijëravjeçare të Shqipërisë. Të dhënat arkeologjike, historike dhe kulturore, dëshmojnë për lashtësinë dhe qëndresën patriotike të krahinave të tij. Krahinat e Matit, thuajse gjatë gjithë udhëtimit të vështirë të shqiptarëve në kohë dhe, sidomos në kulmimet historike, i kanë dhënë atdheut prijës të dëgjuar dhe shtetarë të zot, njerëz të pendës e të mendimit.

Një ndër këto krahina, ajo e Prellit, ka nxjerrë nga gjiri i saj bij që kanë bërë emër në shërbim të atdheut, kulturimit të tij, lirisë dhe flamurit. Një ndër ta është padyshim Shahin Toçi, i cili dha jetën në lulen e rinisë për mbrojtjen e simbolit të kombit, flamurit.



Fshati Urxallë

Shahin Toçi lindi më 15 prill të vitit 1914 në fshatin Urxallë, në një familje të thjeshtë, bujare, punëtore dhe e besës, që brez pas brezi trashëgoi vlera të patriotizmit të vërtetë, duke iu përgjigjur thirrjes së atdheut në çdo periudhë të vështirë të historisë së tij.

Praninë e burrave të saj në ngjarjet e shënuara të historisë së Matit e të Shqipërisë kjo familje e ka provuar me gadishmërinë dhe trimërinë e tyre. Stërgjyshi dhe gjyshi i Shahin Toçit, Bajram dhe Stafë Toçi ishin ndër prijësit e lëvizjeve popullore matjane kundër robërisë turke dhe pushtesve serbë e malazezë. Osmani, babai i Shahin Toçit, mori pjesë në luftimet e matjanëve kundër serbëve në Shkallën e Deshëve dhe iu përgjigj thirrjes së Kuvendit të Bruçit për sulmimin e garnizonit fashist në Burrel në korrik të vitit 1943. Në vijimësi të traditave atdhetare të kësaj familje, vëllai i Shahin Toçit, Dylja, mori pjesë në luftën çlirimtare kundër pushtesve fashistë e nazistë.



Hyrja në shtëpinë muze në Urxallë, Mat



Shtëpia ku ka lindur patrioti i madh shqiptar Shahin Toçi, e cila sot është shtëpi muze





Portreti i patriotit Shahin Toçi, qëndron mbi Urxallë. Foto e realizuar nga Maringlen Gjestila



Brenda shtëpisë muze ku janë ekspozuar të gjitha reliket origjinale të patriotit Shahin Toçi

STUDIMET NË TIRANË

*Për të kërkuar dhe mbrojtur të drejtën e tij,
i etur për dije dhe përparim,
edhe pse në një moshë të njomë,
përshkoi në këmbë rrugën
nga vendlindja në Tiranë .*

I mbruajtur që në fëmijëri me vlerat e atdhedashurisë, Shahin Toçi e kaloi moshën parashkollore në vendlindjen e tij. Më pas, në saj të kujdesit të prindërve dhe të dëshirës së tij të madhe për shkollim, nis mësimet në shkollën fillore të Derjanit në Mat, një ndër shkollat e para të hapura në Shqipëri pas Kongresit të Lushnjës.

Gjatë viteve të para të shkollimit, ai dallohet mes nxënësve të tjerë për arritje cilësore në mësimet dhe dëshirën e madhe për të lexuar.

Fill pas mbarimit të shkollës në Derjan, Shahin Toçi kërkoi vazhdimin e studimeve të mëtejshme në shkollat e niveleve më të larta. Për meritë të tij, në bazë të rezultateve të larta të arritura në përfundim të shkollës në Derjan, iu akordua e drejta e studimit me bursë të plotë për vitin shkollor 1929 - 1930 në Shkollën Mbretërore Ushtarake në Tiranë. Por e drejta e studimit iu mohua nga drejtuesit vendorë të atëhershëm, të cilët e tjetërsuan atë.


Për të kërkuar dhe mbrojtur të drejtën e tij, i etur për dije dhe përparim, Shahin Toçi, edhe pse në një moshë të njomë, përshkoi në këmbë rrugën nga vendlindja në Tiranë dhe ia arriti qëllimit.



Mes shokëve në Shkollën Mbretërore Ushtarake në Tiranë

Pas shumë përpjekjesh personale dhe të përkrahjes së prindërve të tij, në shtator të vitit 1930, Shahin Toçi, nis studimet në Shkollën Mbretërore Ushtarake. Në Shkollën Mbretërore Ushtarake, në javët e para të studimit dhe kohës së lirë, djaloshi nga Urxalla ra në sy për disiplinën dhe korrektesën e lartë me të cilat ndiqte mësimet. Shkolla ku ai nisi studimet, si një shkollë e drejtimit ushtarak, e dekretuar me ligj më 26.10.1928, impononte dhe kërkonte nga nxënësit disiplinë e përpikmëri në orarin e veprimeve.

Siç del nga vlerësimet e mësuesve dhe shokëve të tij, nga fletoret, librat dhe shënimet e ndryshme që kanë ardhur deri në ditët e sotme, Shahini shquhej për një organizim të kujdesshëm e korrekt të ditëve mësimore dhe orarit të studimit. Si rezultat i një pune studimore të organizuar mirë, vitin e parë shkollor e mbaron me vlerësime maksimale, duke formësuar një bazë të sigurtë dhe për vitin e dytë të shkollës. Në shtëpi, pranë prindërve dhe të afërmëve, kthehet në korrik të vitit 1931. Edhe gjatë pushimeve verore lexon vazhdimisht për sistemimin e njohurive të marra. Kohën më të madhe ia kushton studimit të italishtes. Kjo do ta ndihmonte shumë në vitet e tjera të shkollimit.



Libër i Shkollës Ushtarake Mbretërore Tiranë

Shënime në Lëndën e Historisë

Gjatë këtyre viteve, studimet dhe përgatitja cilësore, tregojnë për një vlerësim më të madh e qëndrim më të pjekur ndaj njohurive të ndryshme. Në vitin e tretë e të katërt të Shkollës Mbretërore Ushtarake, shfaqet te Shahini një prirje e qartë studimore e hulumtuese, sidomos në drejtim të historisë, gjeografisë, ekonomisë dhe letërsisë. Shihet se nuk është thjeshtë një dëshirë për të lexuar a orientim i rastësishëm drejt këtyre shkencave. Puna e tij në këtë drejtim është e organizuar deri në detaje. Mbështetëj në librat e historisë, gjeografisë, letërsisë, leximet suplementare të dhëna nga mësuesit përgjegjës të lëndëve, por siguronte vazhdimisht literaturë dhe lexonte libra të fushës ekonomike e shoqërore.

Note

Ad 5 maggio sono
dividuto la nostra
famiglia il giorno
di pasqua
con 24 II 33 mi ha
uscito un denton
No sono nato 1974
nel 15 aprile .)

Në përfundim të Shkollës Mbretërore Ushtarake, Shahin

Toçi kishte krijuar fizionominë e një të riu të pjekur, me kulturë të gjerë dhe vetëdije të qartë për domosdoshmërinë e arsimit e kulturimit në shërbim të atdheut. Mbi këtë domosdoshmëri ai kishte filluar të shprehej edhe në bisedat me shokët, të cilët e respektonin shumë.

Koha gjatë së cilës Shahin Toçi ndoqi dhe përfundoi studimet në Shkollën Mbretërore Usharake në Tiranë, qe një periudhë e vështirë ekonomike për gjithë vendin. Këtë periudhë të vështirë ekonomike dhe sociale e kishin ndjerë dhe të rinjtë shqiptarë që vazhdonin studimet në shkollat e ndryshme të vendit. Tashmë ata ishin më të vetëdijshëm për gjendjen që po kalonte Shqipëria dhe rolin e tyre në përballjen me vështirësitë dhe nevojat e vendit. Mes tyre Shahin Toçi dallohej për një qartësi dhe gjykim të shëndoshë mbi situat e krijuara. Te ai nisën të spikatin qartë prirjet e një vëzhguesi të hollë, me një interes të dukshëm ndaj rrjedhjes së ngjarjeve brenda dhe jashtë vendit. Ndiqte me kujdes shtypin e kohës dhe analizonte në këndvështrimin e politikës së atëhershme shqiptare marrëdhëniet e shtetit shqiptar me shtetin e përtej Adriatikut, Italinë fashiste, e cila në ato moment të vështira kishte ndërprerë huatë për Shqipërinë duke kaluar në kërcënime ushtarake.

Pas mbarimit të studimeve në Shkollën Mbretërore Ushtarake, në verën e vitit 1934, sipas shënimeve të vetë dëshmorit, Shahin Toçi kthehet në vendlindje. Gjatë kësaj kohe, veç të tjerash, do të mendonte edhe për mundësinë e vazhdimit të studimeve ushtarake jashtë vendit. Intuita, aftësia e një vëzhguesi të hollë, leximet e shumta dhe përballjet e reja ja kishin zgjeruar hapsirat e mendimit për të kuptuar se ekzistonin mundësi dhe më të shumta për studime më cilësore.

Shënim
 Toçi, Profesori
 (H. Bakamete) 28/11/32

Masat e volumere.


Volumi i kubit gjendet me
 nëll formulë:

$V = b^3$ (sepse i ka 6 faqet anore
 (catrozetë njëjtin
 3

$V = 8 \times 8 \times 8 = 64 \times 8 = 512 m^3$

Kubi

Baza = 8
 Kubi.



Shënime të patriotit në lëndën e Matematikës, Shkolla Mbretërore Ushtarake Tiranë



Në Shkollën Mbretërore Ushtarake Tiranë. Shahin Toçi, i pari nga e djthta

STUDIMET NË NAPOLI

*...Jeta ime është e atdheut tim,
është e flamurit të tij.*

Përballë nevojave të ushtrisë shqiptare për kuadro të arsimuar e të specializuar, numri i nxënësve dhe oficerëve që dërgoheshin për studime jashtë vendit rritej nga viti në vit. Për nxënësit e Shkollës Mbretërore Ushtarake kriteri kryesor mbetej niveli cilësor i përgatitjes. Shahin Toçi ishte ndër nxënësit më cilësorë që mbaruan studimet në këtë shkollë. Në vitin 1934, për studime të mëtejshme në Itali do të shkonin 30 – 35 nxënës të kësaj shkolle. Të drejtën e kërkesës për të vazhduar studimet jashtë vendit e kishin të gjithë nxënësit e Shkollës Mbretërore Ushtarake, por, më tej, kandidatët i nënshtroheshin një konkursi para një jurie të përzgjedhur, në përbërjen e së cilës ishte dhe një specialist ushtarak italian. Konkurimi ishte tepër rigoroz dhe kërkonte përgatitje mjaft cilësore. Testohej përgatitja e përgjithshme shkencore, përgatitja fizike dhe gjendja shëndetësore. Gjatë këtij konkurimi Shahin Toçi u vlerësua shumë mirë në përgatitjen shkencore dhe arriti të përballojë me sukses dhe konkurimin në përgatitjen fizike.



Në Kolegjin Ushtarak, Napoli



Shkolla Ushtarake në Napoli

Pa u shuar ende malli i katër viteve larg prindërve, të afërmeve dhe shokëve, Shahin Toçi do të udhëtonte për të qenë edhe tre vite larg tyre, larg Urxallës, Matit, Tiranës e Shqipërisë. Në ditën e nisjes, bashkëkohësit kujtojnë se Osman Toçi, me duart e mbështetura mbi supet e të birit, të ketë thënë:

- Bir! Pas pak do të marrësh udhën e detit. Prapa do të lësh më shumë se Urxallën e Matin, do të lësh Shqipërinë, atdheun tënd. Mos harro se atje ku do të shkosh është tjetër vend, tjetër dhë. Sado i bukur të jetë ai vend, dheun tënd nuk e zë. Unë besoj te ti Shahin, por zemra më thotë të t'i them këto fjalë.

E Shahin Toçi i është përgjigjur të atit:

- Faleminderit babë! Ti, gjyshi e mësuesit m'i keni mësuar mirë kufijtë e Shqipërisë dhe unë nuk do t'i harroj kurrë ata, jeta ime është e atdheut tim, është e flamurit të tij.

Në tetor të vitit 1934, Shahin Toçi nis studimet në Kolegjin Ushtarak të Napolit në Itali. Këtu nisi të formohej jo vetëm si ushtarak i zoti me dije të gjithanshme në fushën e artit ushtarak, por edhe si studiues i hollë i lëndëve bazë të këtij arti.

Gjatë tre viteve të studimeve në Napoli, Shahin Toçi bën pjesë në grupin e katërt të kursit " Bianchini", midis 120 studentëve të kompanisë së tretë. Në kursin " Bianchini", nëpër kompani të ndryshme, krahas tij vazhduan studime edhe student të tjerë shqiptarë.

Shpërndarja e studentëve shqiptarë nëpër kompani të ndryshme, s'kishte të bënte vetëm me mënyrën e organizimit, por, më shumë se kaq kishte një qëllim tjetër: kufizimin e çdo mundësie grupimi brenda dhe jashtë mjediseve të shkollës, me prirje atdhetare dhe kundërshtuese ndaj përgatitjes për pushtimin e Shqipërisë. Përpyekjet e Shahin Toçit për të mësuar e përvetësuar më shumë se ç'jepej në tekstet dhe literaturën shkollore, si një prirje e dukshme që në vitet e para të shkollimit të mëparshëm, duken qartë dhe në shkollën Ushtarake të Napolit.



Diploma e marrë në Akademinë Ushtarake në Napoli

Periudha tre vjeçare në Napoli, ka qenë koha gjatë së cilës Shahin Toçi, nisi studimet në drejtim të përvetësimit cilësor të gjuhës italiane e franceze dhe leximet e vazhdueshme filozofike dhe letrare. Zakonisht kohën e lirë ai e kalonte në Bibliotekën Kombëtare të Napolit dhe atë të shkollës.

Në korrik të vitit 1937, Shahin Toçi kthehet në atdhe.

STUDIMET NË MODENA

Në bazë të përzgjedhjes së bërë nga sektori ushtarak për arsimimin e mëtejshëm të studentëve, që kishin kryer studimet në shkollat ushtarake, në tetor të vitit 1937, iu dha e drejta për kryerjen e studimeve akademike në Modena 34 studentëve. Ndër të parët, ishte dhe Shahin Toçi.

Studentët shqiptarë të regjistruar në vitin 1937 në Akademinë e Këmbësisë dhe Kavalerisë në Modena, nisën studimet në dy kurse: "Audacia" dhe "Impero".

Në kursin e tetëdhjetë, "Audacia", u regjistruan njëzetë studentë shqiptarë. Të njëzetë studentët shqiptarë u inkuadruan në kompaninë e parë, të dytë dhe të tretë. Shahin Toçi u regjistrua në kompaninë e tretë.

Që në fillim të vitit akademik, ai u kushton një rëndësi të madhe leksioneve dhe ndjek me kujdes të gjitha seancat teorike dhe praktike. Pas marrjes së leksioneve në lëndë të ndryshme, studion rregullisht mbi temat e drejtimeve shkencore dhe librat e specialitetit të tij duke zgjeruar kështu horizontin e njohurive përmes leximit të literaturës plotësuese.

Në përfundim të kohës së parë të studimeve, si rezultat i një pune të organizuar mirë e në vijueshmëri, Shahini e kalon sezonin e parë të provimeve, duke treguar para komisioneve një përgatitje të lartë teorike-shkencore dhe praktike. Mbi këtë bazë, ai do të nis dhe fazën e dytë të studimeve akademike.



Hyrja e Akademisë Ushtarake Modena



*Mes kolegëve, gjatë studimeve në Modena
(i dyti nga e djathta)*

Në të gjitha provimet që dha, Shahin Toçi u paraqit shumë mirë. Pas përfundimit me sukses të vitit akademik 1937-1938 ai diplomohet në Akademinë e Këmbërorisë dhe Kavalerisë së Modenas. Serioziteti dhe këmbëngulja e tij e admirueshme u bënë shembull dhe për studentët e tjerë shqiptarë.

Shahin Toçi u kthye në atdhe në vitin 1938. Pas disa ditëve qëndrimi në vendlindje thirret nga Ministria e Mbrojtjes, në të cilën punon disa javë. Puna e tij në këtë ministri nuk zgjati shumë, pasi shteti shqiptar do ta dërgonte për specializim pasakademik në Itali.

Përgjithësisht, nxënësit dhe studentët ushtarakë manifestonin sjellje që tregonin qëndrime të qarta patriotike. E gjithë kjo vihej re nga pedagogët e ushtarakët italianë.

Mes studentëve, Shahin Toçi ishte ndër të parët që krenarisë kombëtare të genurit shqiptarë, i jepte një kuptim shumë të madh.




Diploma e marrë në Akademinë Ushtarake në Modena

SPECIALIZIMI NË ROMË

*Të vdesësh një herë dhe i ndershëm
është më shumë se të lindësh
një mijë herë dhe tradhëtar.*

Shahin Toçi ishte i vetëdijshëm për kohën që po kalonte Shqipëria, rajoni, Europa dhe bota. E ndjente se ngjarjet mund të rrokulliseshin shpejt. Në Itali ai do të gjente një atmosferë, megjithëse në dukje miqësore, më provokative. Shenjat e kësaj atmosfere provokative i kishte ndierë që në muajt e fundit të studimeve akademike.

Afërmendsh që Shahin Toçi ishte në dijeni për situatën e krijuar. Ai ishte një ndër oficerët e besuar, devotshmëria e të cilit ishte provuar dhe në javët e punës në Ministrinë e Mbrojtjes.



Shahin Toçi, rreshti i parë, i treti nga e majta

I dërguar për specializim pasakademik nga shteti shqiptar, oficeri Shahin Toçi vendoset në Romë në tetor të vitit 1938, në një bujtinë në rrugën Trans - Tevere nr. 45. Në këtë dhomë do të kalojë ditët, javët dhe muajt, deri në ditët e netët e trazuara të fund majit të vitit 1939.

Edhe pse kohën më të madhe e kalonte mes librave, gjente kohë të qëndronte me shokët e tij oficerë dhe studentë të tjerë shqiptarë. Kujtonin vendin e tyre dhe bisedonin për tema të ndryshme. Tema e ditës, ajo e rrezikut të pushtimit të Shqipërisë nga Italia dhe e mundësisë ushtarake për të përballuar një sulm të mundshëm ishte tema më e diskutueshme.

Mes oficerëve dhe studentëve shqiptarë Shahin Toçi dallohej për një këndvështrim të qartë e të pjekur të situatës që po kalonte Shqipëria dhe të zhvillimeve të gjithanshme botërore. Si njohës i mirë i historisë së luftërave ndërbalkanike, Luftës së Parë Botërore dhe synimeve të vazhdueshme të fqinjëve për copëtimin e Shqipërisë, ndjente dhe theksonte me forcë se, përtej propagandës, ndihmave dhe investimeve, Italia synonte gllabërimin e Shqipërisë. Ai theksonte se “para se të jemi studentë ushtarakë në Itali, jemi shqiptarë, ndaj duhet të tregojmë me sjelljen dhe qëndrimin tonë se për ne Shqipëria është mbi të gjitha”.

Veprimtaria e oficerëve dhe studentëve nismëtarë të një rezistence gjithnjë në rritje, nuk kishte kaluar pa u vënë re nga shërbimet sekrete italiane. Me studentët, agjentët e shërbimit sekret nisën një punë të kujdesshme, fillimisht duke penetruar në radhët e tyre me anë të studentëve italianë.

Propaganda ishte e fuqishme dhe përdorte gjithë mjetet për realizimin e qëllimeve të saj. Si çdo diktaturë, fashizmi e kishte propagandën armën e armëve. Ndryshe vepronte shërbimi sekret me oficerët. Veprimi ndaj tyre ishte më i drejtpërdrejtë. Ndaj tyre u ndoq rruga e survejimit, por dhe e presionit. Edhe pse i qetë si natyrë, i përmbajtur dhe i kujdesshëm, edhe Shahin Toçi nuk kishte mundur t'i shpëtonte këtij survejimi, megjithatë, takimet me shokët në Romë dhe në qytetet e tjera të Italisë, ku studionin studentët shqiptarë, nuk i ndaloi.

Një ditë pas thyerjes së rezistencës së patriotëve shqiptarë, kryesisht në qytetet bregdetare, të shtunën në mëngjes, me 8 prill 1939, trupat pushtuese

fashiste iu drejtuan Tiranës dhe, pas disa orësh, hynë në kryeqytetin shqiptar. Në ditët që vijuan, nxënësit, studentët dhe oficerët shqiptarë në shkollat italiane, të pezmuar, të zymtë e indiferentë ndaj auditoreve, grupoheshin gjithnjë e më shumë, brenda dhe jashtë dverve të shkollave. Ideja për t'u organizuar e për të kapërcyer Adriatikun, duke braktisur studimet, po dilte gjithnjë e më e qartë në bisedat e tyre.

Grupi organizator i kundërshtimit të pushtimit nisi të bënte një punë bindëse më të shpeshtë e më të organizuar. Kërkohej që kundërshtimet tani të ishin më të hapura dhe më të drejtpërdrejta. Në një nga këto takime të ditëve të para të majit Shahin Toçi theksonte me forcë: "Këta që e mbajnë veten të qytetëruar flasin gjithkund me fjalë të bukura për të justifikuar grabitjen e lirisë së popujve. S'ka mbetur rrugë tjetër veçse të kthehemi në atdheun tonë dhe të rrokim armët. Atje s'ka humbur as besa, as burrëria. Atje mund të organizohemi edhe më mirë për të hedhur tutje robërinë".

Ndërsa përgjigja e Shahin Toçit ndaj disa shërbëtorëve të fashizmit, të lëkundurve dhe frikacakëve që mbanin në gojë parullën "Kush prek fashizmin prek vdekjen", ishte: "Të vdesësh një herë dhe i ndershëm është më shumë se të lindësh njëmijë herë dhe tradhtar".

Fashistët, të cilët, përmes agjentëve të tyre përgjonin tërë veprimtarinë e nxënësve, studentëve dhe oficerëve shqiptarë, kishin arritur të evidentonin qartë organizatorët, mes tyre, si ndër më të betuarit, Shahin Toçin.

NË MBROJTJE TË FLAMURIT

*Mund të ndërrohen dhe uniformat,
por flamuri jo; atdheu mbetet po ai!
Mjerë kush nuk e kupton këtë
dhe e tradhëton flamurin e atdheut të tij!
Ne i biem në gjunjë vetëm flamurit tonë,
vetëm shqiptonjës tonë i falemi.*

Fashistët filluan të mendonin për të organizuar veprimtari të ndryshme që kishin për qëllim zbehjen e revoltës që po ziente në gjokset djaloshare të oficerëve dhe studentëve shqiptarë dhe bindjen e tyre për t'i kthyer në kontigjente të fashizmit. Qëllimi final i fashistëve ishte që studentët dhe oficerët shqiptarë t'u bashkoheshin trupave pushtuese në Shqipëri, të cilat nuk ishin pritur me lule, siç kishin shpresuar dhe propaganduar ata, por me grykën e pushkës dhe me qëndresë të pa imagjinueshme.



Me fillimin e muajit maj, autoritetet drejtuese të shkollave ushtarake shpalosën haptazi para studentëve fillimin e përgatitjeve për betimin para flamurit italian. Me një qëllim tejet të paracaktuar, kjo veprimtari ishte planifikuar me ngut nga qeveria dhe Ministria e Luftës italiane që me zbarkimin e trupave fashiste në Shqipëri. Përfshirja e ushtarakëve shqiptarë në këtë ceremonial betimi, sipas autoriteteve fashiste, veç të tjerash, do të nënkuptonte miratimin e “zbarkimit” të tyre. Falë veprimtarisë patriotike të oficerëve dhe studentëve më aktivë, kundërshtarë të deklaruar të pushtimit fashist, studentët shqiptarë e kuptuan se autoritet italiane, me anën e kësaj veprimtarie, kërkonin t’i bënin palë në pushtimin e atdheut të tyre.

Oficerët specializantë në Romë e në qytete të tjera italiane u bënë koordinuesit e veprimtarisë së studentëve në qytetet e ndryshme të Italisë. Si ish-student i Akademisë së Këmbësisë dhe Kavalerisë së Modenas, Shahin Toçi filloi të takohej më shpesh me grupet e studentëve në Modena.

Në një nga ditët e fundit të muajit maj 1939, nga autoritetet fashiste, nën kujdesin e nënsekretarit të shtetit për Luftën, u organizua një ceremoni parabetimi. Atë ditë, nënsekretari i shtetit për Luftën, që kishte zënë vend mes oficerëve dhe autoriteteve të tjera, ndërsa qëndronte para kuadrateve ushtarake, ndali vështrimin mbi njërin prej oficerëve shqiptarë. Nuk priti t’i jepnin shpjegime të gjata: zbriti shkallët dhe bëri me hap të shpejtë drejt kuadratit mbi të cilin ishte ndalur pak më parë vështrimi i tij i vrenjtur. Pas e ndoqën disa nga oficerët e tij. Ende pa ndalur ecjen nervoze, pyeti oficerin shqiptar:



- Po ju?

Djaloshi shqiptar, që në uniformën e tij kishte hedhur një shirit kuq e zi, foli:

- Zoti gjeneral, oficeri shqiptar Shahin Toçi!

- Ç'do të thotë kjo?! Ç'është kjo uniformë!

- Unë jam shqiptar, zoti gjeneral dhe kjo është uniforma e shtetit tim. Gjenerali qeshi hidhur.

- Ç'vlerë ka ajo uniformë? Tashmë mbreti juaj ka rënë.

Ju tani keni fatin të mbani një uniformë të madhe, atë të Mbretërisë së Madhe të Italisë, pa atë shirit kuq e zi mbi të.

Oficeri shqiptar ndjeu gjakun t'i pulsonte me forcë, por u përmbajt.

- Gaboheni, zoti gjeneral! Mbretërit edhe mund të bien, mund të ndërrohen dhe uniformat, por flamuri jo; atdheu mbetet po ai, zoti gjeneral! Mjerë kush nuk e kupton këtë dhe e tradhton flamurin e atdheut të tij! - ngriti zërin oficeri shqiptar duke u kthyer nga shokët e tij.

Kishte folur me zë të lartë. Nën zërin e tij ra heshtja. Gjenerali mendoi se, aty për aty, ajo heshtje do të ishte gjithçka për të kapërcyer atë moment delikat dhe situatën që mund të krijohej. Intuita e tij prej ushtaraku të regjur e dinak, e bëri të mendonte se oficeri shqiptar, që i përplasi në fytyrë ato fjalë, nuk ishte i vetëm. Në sytë e shokëve të tij shprehej qartë admirimi për guximin e patriotit të tyre. Si për të ruajtur në kujtesë pamjen e oficerit shqiptar dhe për t'u siguruar se kishte përballë njërin prej organizatorëve më të rëndësishëm, gjenerali e shikoi drejt e në sy Shahin Toçin. Vështrimi krenar i oficerit shqiptar mbeti i palëvizur. Gjenerali u kthye i nervozuar nga kishte ardhur.



Më pas, përmes një fjalimi për fuqinë ushtarake dhe ekonomike të Italisë fashiste, gjenerali u mundua të bindte ushtarakët shqiptarë se zbarkimi i trupave në Shqipëri bëhej për ruajtjen e pavarësisë së saj, bashkimin e trojeve shqiptare dhe zhvillimin ekonomik e shoqëror të Shqipërisë. Ai u kujtoi më pas ushtarakëve shqiptarë se betimi ceremonial ishte për ta, para së gjithash, një detyrë. Pas fjalës së tij, njëri nga oficerët italianë lajmëroi se të nesërmen paradite do të niste ceremonia e betimit ushtarak.

Të nesërmen kuadratet u rreshtuan përsëri. Para studentëve dhe oficerëve shqiptarë, njëri nga oficerët madhorë italianë lexoi formulën e betimit, por ushtarakët shqiptarë nuk u përgjigjën. U krijua një heshtje e tensionuar. Oficeri fashist hodhi një vështrim mbi kuadratet ushtarake dhe nisi të lexojë me zë të lartë. Përsëri heshtje.

Atëherë gjenerali zbriti shkallët, qëndroi përpara kuadratit dhe thirri kërcënueshëm:

- Lo giurate voi?

Priti një përgjigje, qoftë dhe kundërshtuese, vetëm të mos qëndronte para asaj heshtje. I dukej se po fundosej i gjallë në atë ftohtësi drithëruese. E ndjeu se po i sosej përfundimisht durimi.

- Betohuni! - më shumë klithi se sa thirri dhe prit një çast si i ngurtësuar.

Në atë çast doli nga rreshti oficeri shqiptar Shahin Toçi dhe, me vështrimin e palëvizur mbi fytyrën e gjeneralit, tha:

- Zoti gjeneral, ne jemi shqiptarë dhe mund të betohemi vetëm para flamurit tonë kuq e zi.

Zëri i tij qe i prerë, i lartë dhe kumbues, me një theks të qartë zemërimi. Oficerët italianë shikuan njëri - tjetrin, jo aq të habitur se sa të hutuar. Pastaj vështrimet e tyre u ndalën mbi nënsekretarin e shtetit për Luftën, në fytyrën e të cilit nuk kishte mbetur pikë gjaku. Sytë e tij, si dy thëngjij të zjarrtë, mundoheshin të lëkundnin vështrimin e qetë, të vendosur e të kthjelltë të djaloshit shqiptar.

- Come? - pyeti edhe njëherë gjenerali, me një zë të çjerrë e idhnak.

- Po, zoti gjeneral! Ju e dini fort mirë se edhe ne, shqiptarët, e kemi një flamur. Ai na ka përcjellë me krenari kur kemi ardhur në tokën tuaj për të studiuar, ai na ka pritur e do t'na presë përsëri. Si mund t'ia kthejmë shpinën? Kurrë, zoti gjeneral! Për atë kemi derdhur aq gjak në shekuj! Sot nuk mund ta përlyejmë me turp. Shqipëria nuk do t'na e falte. Ne jemi bijtë e saj, ajo na ka

rritur, ndaj kurrë prej nesh s'ka për t'u shitur. Ne i biem në gjunjë vetëm flamurit tonë, vetëm shqiponjës tonë i falemi.

- Të lumtë Shahin! - thirri njëri nga oficerët shqiptarë.

Sakaq rreshtat lëvizën dhe kuadratet u shformuan. Disa prej studentëve ulën armët. Gjenerali, i ndjekur nga oficerët e tij, u largua duke murmuritur nëpër dhëmbë gjysma fjalësh. Mbi studentët shqiptarë që hodhën armët u lëshuan agjentët e SIM-it. Studentët dhe oficerët shqiptarë shpërthyen në thirrje për flamurin dhe atdheun e tyre.

Kishte përfunduar pa sukses përpjekja e fashistëve për të bërë pjesë të qëllimeve të tyre studentët dhe oficerët shqiptarë që studionin në Itali. Ndërsa mbi emrin e oficerit shqiptar Shahin Toçi, mbase pak orë pas dështimit të provës ceremoniale, ishte urdhëruar të vihej kryq.

Shahin Toçi në orët e mbetura të asaj dite u survejua rreptësisht në çdo hap që bëri. Në përplasjen e tij të guximshme me nënsekretarin e shtetit për Luftën, fashistët kishin parë me sytë e tyre njërin prej drejtuesve të një rezistence të mundshme të armatosur në të ardhmen në Shqipëri. Qëndrimin e Shahin Toçit nuk mund ta kalonin lehtë. Kthimi i Shahin Toçit në Shqipëri, për fashistët, ishte po aq i rrezikshëm, në mos më shumë, se qëndrimi i mëtejshëm i tij në Itali. Për ta ai po shfaqej qartë se do të ishte një ndër drejtuesit e zot të lëvizjes çlirimtare kundër tyre. Ata kishin provuar edhe përmes agjentëve të tyre të fshehtë në radhët e oficerëve shqiptarë se ai nuk mund të thyhej. Mbetej vetëm një rrugë për t'ia arritur këtij qëllimi.

Edhe oficeri shqiptar Shahin Toçi e kishte kuptuar se qëndrimi i tij i mëtejshëm në Itali ishte tepër i rrezikshëm.


ÇDO DITË E KA NJË DIELL

Ajo flakëz u zmadhua e u zmadhua dhe mori trajtën e një ekрани gjysmë të ndriçuar në cilën nisën t'i kalonin para syve brigjet e Shqipërisë, në rrugën përmes fushave për në Tiranë, e përpjeta e Qafë-Shtamës, lugina e blertë e Matit, malet rreth e qark sajtë lidhura si një valle qiellore, vargëzimet e kodrave poshtë Dejës bardhane dhe Urxalla e tij e dashur rrëzë kashnjetit e mbuluar me kurore dehëse të luleve kumbullave.

Pas një bisede me disa nga studentët dhe oficerët shqiptarë, Shahin Toçi mori rrugën për në bujtinë. Nata sapo kishte rënë. Dhomën e gjeti hapur. Ajo ishte kthyer përmbys. Pasi e rregulloi atë qëndroi për një çast para dritares së saj pastaj u shtri në krevat me sytë e fiksuar mbi hartën e Shqipërisë, të varur në murin përballë. Sa e kishte marrë malli! E kishte lënë të lirë e do ta gjente të pushtuar. Këta duan të na lidhin pas qerres së tyre, mendoi, që kur të kthehem të jemi palë me ta në robërimin e Shqipërisë. Ç'poshtërsi do të ishte!

U ngrit, mori në një nga sirtarët e raftit fletoren e ditarit dhe u ul në tavolinë. Nisi të hidhte në fletore përshtypjet e asaj dite. Pas pak dritat u shuan, ndërsa në ndërtesat përballë ato ishin ndezur. Ndezi një qiri dhe e vendosi mbi tavolinën e punës. Pasi tërhoqi një fletë të bardhë nga tavolina, nisi të shkruaj një letër, megjithëse shumë pak shpresa kishte se mund të takonte dikë që udhëtonte për në Shqipëri.

Që në fillim të vitit lëvizjet drejt Shqipërisë ishin bërë të vështira, aq më tepër pas muajve mars dhe prill. Megjithatë ai ishte optimist. Çdo ditë e ka një diell, thoshte shpesh kur të tjerët shikon të ardhmen të zymtë. Mbase dhe mund të krijohet një mundësi për dërgimin dorazi të asaj letre. I dashtuni babë...! Kishte javë që nuk i shkruante të atit.



Letër dërguar prindërove, mars 1939

Teksa vazhdonte të shkruante letrën, ngriti kokën dhe mbeti për një çast i menduar me shikimin mbi flakën e zbehtë të qiririt. Pak e nga pak, ajo flakëz u zmadhua e u zmadhua dhe mori trajtat e një ekrani gjysëm të ndriçuar, në të cilin nisën t'i kalonin para syve brigjet e Shqipërisë, rruga përmes fushave për në Tiranë, e përpjeta e Qafë-Shtamës, lugina e blertë e Matit, malet rreth e qark saj të lidhura si në një valle qiellore, vargëzimet e kodrave poshtë Dejës bardhane dhe Urxalla e tij e dashur rrëzë kashnjetit, e mbuluar me kurorën dehëse të lulekumbullave. Iu kujtuan shokët e fëmijërisë me të cilët luante livadheve, zallishtes së Përroit të Thatë, ngjitej në kashnjet dhe në Qafën e Shën-Kollit, aty ku shpesh uleshin nën hijen e lisave shekullorë e shokët i kërkonin t'u lexonte vjershat e Naimit, Mjedës, Fishtës...

Pastaj, në atë ekran të zbehtë iu faneps gjyshi i tij i mirë, hipur mbi kalin e bardhë teksa i tregonte një histori të bukur; nënë Merjemja, duke zbritur poshtë shtëpisë, me krahët e zgjatur drejt tij; dy vëllezërit që vinin pas të atit për t'i uruar mirëseardhjen....

Qepallat po i rëndoheshin. Mbështeti kokën mbi libër në një përgjumje

të këndshme. Pas pak, pas tij dera u hap ngadalë dhe flaka e qiririt vizatoi në murin e dhomës, pas shpinës së tij, dy hije që afroheshin e afroheshin duke marrë pak e nga pak frymën e flakës së qiririt. Befas flaka e tij u shua. Hijet humbën në errësirë dhe në atë qetësi të kobshme u dëgjuan një..., dy..., tri... krisma të shurdhëta. Përtej dritares, në lartësinë e qiellit, vetëm yjet ndriçonin: të largët, të largët... Hijet u larguan. Dhe dritat u ndezën, po Shahin Toçi nuk u zgjua. Me kokën mbi libër kishte mbetur në ëndrrën e ndërprerë. Kishte kaluar mesnata. Dita e re ishte në të ardhur.

Kishin kaluar orët e para të mëngjesit të asaj dite maji, kur para bujtinës mbërritën studentë dhe oficerë shqiptarë. Po asnjëri nuk u lejua të hynte për të shikuar shokun e tyre të vrrarë. Qëndruan për disa orë aty me shpresë se do t'i lejonin, por qe e pamundur. Në momentin kur agjentët e policisë sollën një autoambulancë ushtarake përpara bujtinës, ushtarakët shqiptarë u afruan në grup dhe kërkuan trupin e pajetë të shokut të tyre për ta përcjellë në banesën e fundit, në tokën shqiptare. Fillimisht agjentët u sollën ndaj kërkesës së tyre me qetësi, duke u thënë se duhej një kohë më e gjatë dhe një vend me kushte më të përshtatshme për të përfunduar ekspertizën e plotë. Por, kur ushtarakët shqiptarë kërkuan që të merrnin pjesë në shoqërimin e trupit të shokut të tyre, agjentët dhanë urdhër që t'i largonin me forcë. Pasdite, studentët shqiptarë i dërguan në qytetet ku ata studionin, ndërsa disa prej tyre, ata që kishin hedhur në mënyrë demonstrative armët në ditën e provës ceremoniale, i izoluan në burgjet e Italisë. Autoritet italiane i druheshin mbajtjes së tyre në grup pas vrasjes së Shahin Toçit.

Ndërkohë, disa nga radiot e ndryshme kishin lajmëruar vrasjen e oficerit shqiptar Shahin Toçi, duke e cilësuar atë si vrasje të qëllimshme për qëndrimin e mbajtur ndaj pushtuesit të vendit të tij. Atë pasdite dhe në paraditen e së nesërme, studentët dhe oficerët shqiptarë që mbetën në Romë, kërkuan pranë autoriteteve italiane të merrnin pjesë në ceremoninë e varrimit të shokut të tyre. Por as kërkesa më njerëzore e tyre nuk u pranua. Nëpër shkollat italiane, ku studionin ushtarakët shqiptarë, u urdhërua që të mos komentohej vrasja e oficerit shqiptar. Çdo komentim mbi vrasjen e tij do të dënohej rëndë.



Shtëpia muze në Urxallë, Mat



Gjatë specializimit pasakademik në Romë

DHIMBJE KRENARE

*Gjakun tonë ne nuk e shesim,
ia falim flamurit.*

Osman Toçi ishte i bindur për qëndrimin e vendosur kundërshtues të Shahinit ndaj pushtuesit dhe, për më tepër, kishte mësuar që ai ndiqej nga shërbimet e fshehta italiane. Megjithatë, shpresonte se në dy muajt e mbetur, deri në përfundimin e specializimit, gjërat do të shkonin mirë dhe Shahini do të kthehej në Shqipëri. Hapësirat komunikuese me të ishin eliminuar. Kishte ditë që ai nuk kishte marrë asnjë letër, asnjë lajm.

Por, në ditët e para të qershorit, erdhi një lajm në Burrel e prej atje në Urxallë. I rëndë kishte qenë ai lajm. Peshën e tij nuk kishin mundur ta mbanin as disa prej burrave të krahinës, të cilët heshtnin kobshëm atë buzëmbremje rrugës për në shtëpinë e Osman Toçit. I kishte pritur në oborr dhe u kishte prirë brenda. Të ulur shesh rreth oxhakut, burrat përsëri kishin heshtur.

- Të rëndë e paski hijen e fjalët ju paskan sosur, burra! - u ishte drejtuar i zoti i shtëpisë.

E kishte ndjerë mandatën që do t'i jepnin ata burra, ndaj nuk kishte pranuar as të ëmën, as të shoqen, as dy djemtë në dhomë. Kafënë po e piqte vetë.

- Flisni, bre burra, po ju pres!

- Piqe të fortë kafënë, Osman Toçi! – kishte thënë njëri prej burrave.

- Të fortë jam mundue me e pjek përherë, or ti! Fol, se boll të kam prit!

- Kryet shëndoshë për Shahinin, Osman Toçi! - kishte ngritur zërin bashkëfshatari.

Osman Toçi kishte lëvizur nga vendi dhe mjekra i ishte dridhur lehtë.

- Mos, bre burrë, se m'i këpute krahët, - kishte thënë, duke vështruar me sytë e përlotur bashkëfshatarin e tij.

- Mbahu Osman Toçi, mos u ligështo! Ti që u ke qëndruar para plumbave, qëndro dhe sot!

- Është i bardhë plumbi, or ti, po ky lajm më vrau e po më lë gjallë. Po si vdiq, a s'po më thoni?

- Si burrat! Të bardhë e pat vdekjen.

- Kush ma vrau djalnin, burra?

- Fashistët... E vranë se nuk u betua për flamurin e tyre.

- Heu! Shumë paskan lyp të zehtë prej Shahinit! - kishte thënë Osman Toçi, duke vështruar çiftelinë e të birit të varur në mur dhe lotët i kishin zbritur mollëzave të kërcyera.

Mortja qëndroi e kobshme si vetë emri i saj mbi shtëpinë e Osman Toçit, mbi Urxallë, mbi krahinën e Prellit e mbi Mat për shumë dit e net. Dhe nuk u mbyll as në të shtatën dit, as në të shtatën javë. Për dy muaj rresht dera e Osman Toçit në Urxallë qëndroi e hapur. Njerëzit nuk sosën së ardhuri. Erdhën nga çdo fshat i Matit, nga fshatrat e Mirditës dhe Dibrës.

Pesha e dhimbjes kishte qenë e rëndë për prindërit dhe të afërmit e Shahin Toçit. E kishin përcjellë të dashurin e tyre me gëzim e krenari për në Itali, me shpresë se do t'u kthehej si përherë buzagaz. Por ai nuk ishte kthyer as i gjallë e as i vdekur. Ata nuk kishin mundur t'i vinin dorën në ballë e as t'i hidhnin një dorë dhë mbi varr.

Gjatë dy muajve Osman Toçi bëri çdo përpjekje për ta sjellë trupin e të birit që të prehej në vendlindje, por pushtuesi, vrasësi i të birit, nuk i dha asnjë mundësi. Në krye të dy muajve e lajmëruan se mund të merrte vetëm rrobat, materialet dhe objektet e të birit. Ky lajm sikur ia lehtësoi pak plagën. Të paktën, do të kishte mundësi të ngushëllohej disi.

Gjatë dorëzimit të materialeve, kur oficeri fashist i ka kërkuar Osman Toçit të bënte gati dokumentacionin për t'i lidhur pension për "humbjen" e të birit, Osman Toçi është përgjigjur:


- Zotni, nuk kam ardhur këtu të shes gjakun e djalit tim. Gjakun tonë ne nuk e shesim, ia falim flamurit.

Përpjekjet e familjes së Shahin Toçit për të sjellë në atdhe eshtrat e të birit nuk reshtën, por zhvillimet e mëvonshme që i përkasin viteve të luftës kundër fashistëve italianë dhe nazistëve gjermane, i bënë dhe më të pamundura këto përpjekje.

Pas çlirimit të vendit, familja e Shahin Toçit dhe populli i krahinës, kërkoi me insistim vlerësimin nga organet shtetërore në rreth e në qendër të veprimtarisë patriotike të Shahin Toçit dhe sjelljen e eshtrave në atdhe. Në vitin 1961, me dekret nr. 3238, datë 20.03 Shahin Toçi dekorohet me "Urdhërin e Trimërisë".

Nëntë vjet më vonë, më 15 tetor 1970, Shahin Toçi shpallet dëshmor i atdheut. Tani jo vetëm familja Toçi, jo vetëm Urxalla, por gjithë matjanët e


ndershëm e patriotë të vërtetë shpresonin e kërkonin nga shteti shqiptar për të vënë në rrugën e zgjidhjes dhe sjelljen e eshtrave të dëshmorit në atdheun për të cilin dha jetën. Mati krenohej me të drejtë me qëndrimin burrëror e patriotik të djalit të tij.



Dekorata " Urdhëri i Trimërisë", akorduar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor në vitin 1961



Më 10 shkurt 1994, dekorohet nga Presidenti i Republikës me "Urdhërin e Flamurit Kombëtar Kl I-rë" me motivacioni : " ATDHETAR I SHQUAR, SAKRIFIKOJ JETËN NË LUFTË PËR LARTËSIMIN E KOMBIT".



Dekorata e akorduar nga Presidenti i Republikës Z. Sali Berisha, shkurt 1994

Ndërsa më 25 mars 2011 dekorohet nga Presidenti i Republikës me “Medalajen e Artë të Shqiponjës”, me motivacionin: NË NDERIM TË THELLË TË AKTIT TË LARTË QYTETAR DHE PATRIOTIK PËR KUNDËRSHTIMIN PËR TU BETUAR SI USHTARAK, PARA FLAMURIT FASHIST ITALIAN, NË MAJ TË VITIT 1939, ÇKA DO TI KUSHTONTE JETËN MË PAS, POR QË DO TË MBETEJ NDËR SHEMBUJT GJITHNJË FRYMËZUES TË DINJITETIT DHE ATDHEDASHURISË”, dekoratë e dhënë gjatë ceremonisë së kthimit të eshtrave të patriotit në atdhe pas 72-vitesh, dorëzuar familjes së Shahin Toçit.



Dekorata e akorduar nga Presidenti i Republikës Z. Bamir Topi, mars 2011

KJO SHQIPËRI KA LINDUR BURRA

*Po të pyes, moj zanë Urxalle,
Pse t'kanë thanë legjendë shqiptare?
Se mbi shkamb ku prita dritën
Shahin Toçin e kam rritun,
Ja kam falur flamurit t'vetëm
Sa të jetë jeta mos me vdekun.*

Matjanët i ngritën këngë birit të tyre flamurtar. Kënga “Kjo Shqipëri ka lindur burra”, deri në vitin 1970 e kënduar odave, në përvjetorët e lindjes e të rënies së Shahin Toçit dhe në përvjetorë festash, ushtoi fuqishëm, me një krenari të ligjshme në Urxallë, në Mat e në gjithë Shqipërinë. Kjo këngë, përmes valëve të Radio-Tiranës, i kapërceu dhe kufijtë e Shqipërisë, duke ngritur peshë dhe zemrat e shqiptarëve në mbarë botën. Ajo u bë pjesë e programeve muzikore kushtuar heroizmit të shqiptarëve në shekuj. Kërkesat për këngën ishin të shumta dhe ajo nisi të transmetohej gati çdo javë. Në dëshirën për të dëgjuar dhe kënduar këngën për Shahin Toçin, ndjehej respekti për jetën dhe veprimtarinë e tij të lartë patriotike, sidomos për aktin heroik në mbrojtje të flamurit.

Në vitin 1972 e më pas, veprimtaria dhe akti patriotik i Shahin Toçit u pasqyrua dukshëm në Muzeun Historik të rrethit të Matit. Këndi muzeal kushtuar Shahin Toçit u pasurua më tej me objekte e materiale të ndryshme, me kujtime e dëshmi të shokëve të tij dhe me punime biografike nga autorë të ndryshëm. Ata që ndihmuan shumë në pasurimin e këndit muzeal kushtuar dëshmorit, qenë intelektualët, mësuesit, të rinjtë dhe njerëzit e profesioneve të ndryshme, që nuk ishin molepsur nga qëllime të ulta dhe nuk kishin rënë prë e intrigave e pasioneve denigruese. Këta njerëz të ndershëm e realistë e kishin kuptuar se figura e Shahin Toçit i kapërcente përmasat e vlerësimit të dhënë deri në atë moment.

Me kërkesën dhe kontributin e popullit të zonës, intelektualëve dhe të rinisë, specialistëve dhe Muzeut Historik të rrethit, shtëpia e Shahin Toçit në Urxallë u kthye në shtëpi muze. Në çdo 5 maj, në përvjetorë të lindjes e të rënies së dëshmorit, kjo shtëpi e bardhë priti e përcolli vizitorë të shumtë. Edhe në muzetë e fshatrave të Matit u pasqyrua jeta dhe veprimtaria patriotike e dëshmorit. Bashkë me shtëpinë muze në Urxallë dhe këndin muzeal në

Muzeun e rrethit të Matit, këto muze, u kthyen në vatra edukimi me ndjenjën e krenarisë kombëtare dhe të dashurisë për atdheun të cilët i shenjtëronte akti i dëshmorit të flamurit.

Gjithashtu, në këtë kohë, shkollës së Mesme të Përgjithshme në Derjan iu dha emri i dëshmorit Shahin Toçi. Ndërkohë, në veprimtaritë e ndryshme kushtuar kësaj figure patriotike, matjanët kërkonin një vlerësim më të lartë të saj, sjelljen e eshtrave të Shahin Toçit në atdhe dhe shpalljen e tij Hero i Popullit.

Pas viteve nëntëdhjetë, atëherë kur ndjenja patriotike mori përmasa të reja dhe shqiponja dy krenare valëvitej si asnjëherë tjetër shesheve, nëpër institucione e kudo, të rënë për flamur e liri nisën të përshfaqen në kujtesën e popullit si simbole krenare, më të nderuar se asnjëherë tjetër. Në janar të vitit 1994 Presidenti i Republikës dekoroi me “Urdhërin e Flamurit të Klasit të Parë” Shahin Osman Toçin: *“Atdhetar i Shquar që sakrifikoi jetën në luftë për lartësinë e Kombit”*. Në shtypin shqiptar, në libra me karakter historik e publicistik, gazetarë e historianë, poetë e shkrimtarë, bashkëkohës e veteranë nisën të shkruajnë për jetën dhe aktin patriotik të Shahin Toçit. Institucionet kulturore, historike e shtetërore gjithnjë e më shumë nisën të përfshijnë në veprimtaritë e tyre jetën dhe aktivitetin patriotik të dëshmorit.

Por kërkesa për sjelljen e eshtrave të Shahin Toçit në atdhe u bë më e fuqishme. Si një thirrje e ditës së rënies dhe e popullit matjan, si një amanet i lënë nga babai Osman dhe vëllezërit e heroit, Dyle dhe Islam Toçi, sjellja e eshtrave të Shahin Toçit në atdhe u bë synimi sublim i nipërve të heroit, Shahin Islam Toçi dhe Osman Islam Toçi. Në ditët e fundit të jetës së tij, Islam Toçi i thotë të birit, Shahinit: *“Ti e di pse të kemi thirrur me këtë emër. Mbaje me nder emrin me të cilin të kam thirrur. Unë do të prehem në dheun tim, ndërsa eshtrat e xhaxhait tënd s’kanë qetësi në dhë të huaj. Unë kam besim se amanetin që më la babai e që unë po jua lë ju s’do ta harroni kurrë.”* Këtë gjë e kishin kuptuar me kohë nipërit e heroit, ndaj s’reshtën kurrë së përpjekuri derisa bënë realitet amanetin e të parëve të tyre.

Vite më vonë, pas triumfit të demokracisë në Shqipëri nipërit e dëshmorit, Shahin Islam Toçi dhe Osman Islam Toçi u ringjallën dhe më shumë shpresën për mundësinë e gjetjes dhe kthimit të eshtrave të heroit të flamurit dhe xhaxhait të tyre.



Dyle Toçi (vëllai i patriotit)



Islam Toçi (vëllai i patriotit)

Në vitin 1993, Shahin Islam Toçi merr rrugën e mërgimit për në Itali, me synimin e e qartë dhe qëndrim të vendosur për të gjetur varrin e xhaxhait të tij dhe për të çuar në vend amanetin e prindërve të tij. Me përpjekje të mëdha mundi të vendosej në Romë dhe që nga ajo ditë nisi me përkushtim të jetësonte amanetin e të parëve të tij. Ishte vetëm 21 vjeç dhe nuk kishte asnjë informacion për vendndodhjen e varrin e dëshmorit pasi ai ishte varrosur në mënyrë të fshehtë dhe bashkëkohësit e tij dinin vetëm se ishte vrarë nga fashistët për qëndrimin e tij burror dhe patriotik në mbrojtje të flamurit kuq e zi.

Paralelisht me kërkimet e tij në Romë, duke bashkëpunuar me të vëllain, Osmanin që shpejt u vendos në Tiranë për t'i dhënë edhe më shumë



*Shahin Islam Toçi,
(nipi i patriotit që mban emrin e tij)*



*Osman Islam Toçi
(nipi i patriotit)*

mbështetje dhe mundësi realizimit të qëllimit të kthimit të eshtrave të dëshmorit, arritën të sensibilizojnë institucionet shtetërore, mediat, shoqatat dhe intelektualët e drejttimeve të ndryshme krijuese për vlerësimin e merituar të figurës së Shahin Osman Toçit.

Vëllezërit Shahin e Osman Toçi me një këmbëngulje e përkushtim tejet të admirueshëm, për asnjë çast nuk e humbën shpresën në rrugën e mundimshme të realizimit të qëllimit të tyre.

Në ditët e finalizimit të qëllimit të tyre, siç tregojnë nipërit e dëshmorit, Shahini dhe Osmani ata patën dhe inkurajimin e institucioneve shtetërore, sidomos përkrahjene e z. Llesh Kola, Ambasador i shtetit shqiptar në Romë dhe miqve italianë drejtues përgjegjës në administratën e varrezave Verano në Romë Ing. Dario Bonani, Maria Longo dhe teknikëve Paolo Xhovangrosi e Silvio Pelikia.

Ndërsa kolonel Vinçenzo Pikoneze, ushtarak në pension, që ka mbaruar studimet ën Akademinë Ushtarake në Modena, ka vlerësuar lart aktin e akademistit Shahin Toçi, duke admiruar këmbënguljen e rrallë të nipërve të tij për gjetjen dhe kthimin në atdhe të eshtrave të xhaxhait të tyre.

Në një nga ditët e para të marsit të vitit 2011, Shahin Islam Toçi, i emocionuar dhe i përbotur ka telefonuar të vëllanë në Tiranë, Osmanin dhe i ka komunikuar mes drithërimave lajmin e gjetjes së eshtrave të xhaxhait të tyre, duke lajmëruar kështu jo vetëm realizimin e amanetit të të parëve të tij, por duke bërë të mundur dhe kthimin në atdhe pas 72-vitesh, të eshtrave të heroit të flamurit Shahin Toçi.

Vlerësimet në kohë e gjithnjë në rritje për figurën e Shahin Toçit tregojnë se kur është fjala për bijtë e tij të rënë për liri e flamur, populli nuk harron. Flamuri, si simboli i një kombi, i dinjitetit dhe krenarisë së tij, i përjetëson emrat e heronjve që ranë për të. Shahin Toçi është njëri nga këta heronj, ndaj dhe flamuri kuq e zi nuk e harroi. Flamuri ynë thirri kohë të reja dhe njerëz të rinj, për të sjellë në atdhe Shahin Toçin, që të prehet nën palët e tij.



Dy nipat e patriotit, Shahin dhe Osman Toçi, në ditën e ceremonisë së kthimit të eshtrave në Atdhe



Gjatë homazheve në hollin e Bashkisë Burrel, 26 mars 2011



Ministri i Mbrojtjes Z. Arben Imami, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Gjeneral Maksim Malaj dhe Gjeneral Abaz Lleshi, duke kryer homazhe për nder të patriotit Shahin Toçi





Personalitetet e larta shtetërore, ushtarake dhe diplomatike me nipat e patriotit Shahin Toçi